



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Zyra Kryetariç

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO			
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA			
Pranuar - Prilapen (MPCans)	29.09.2022		
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Smirje Prilog	Vitet Vještina
01-	110/05-	1063	



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d, neni 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Transparencën në Komuna, neni 7 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, dhe neni 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën: 28.09.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen në diskutim publik Draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik lokal 2022-2026

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miratim vendimin për lënien në dispozicion për diskutim draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2022-2026.

Neni 2

Propozimi në diskutim publik i Draft Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2022-2026 do të jepet në diskutim publik nga data 01.10.2022 deri me datën 31.10.2022, nga ora 8:00-16:00. Propozimet, sugjerimet për plotësim ndryshim apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes së debatit publik, gjithashtu në formën të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së dëgjimit publik në Zyrën e Drejtorisë për Financa të Komunës të Vitisë, ndërtesa e komunës, si dhe në forme elektronike mund të dërgohen në emalin adresën Nexhat.i.Arapi@rks-gov.net. Dokumenti gjendet në web faqen e komunës së Vitisë, kk.rks-gov.net/viti.

Neni 3

Debati publik do të mbahet me datën 02.11.2022, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë

Neni 4

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive për draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2022-2026.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi ditën e publikimit në web faqen e komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi